



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Dorezuar Priljenar / Predato Received / Delivery	20. 11	2020	viti god year
Organ / Ajsista Organ / Jednica Org / Unit	Strp / Kib / K	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
		2078/200/14	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.295/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Ilire Mehmeti Shaqiri - Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën A. Nr.295/2020 të parashtruar me datë 09.10.2020 nga ankuesi [REDACTED] me adresë banimi në Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Drejtësisë - Instituti i Mjekësisë Ligjore, në çështjen juridike “Masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.Nr.295/2020 e datës 09.10.2020, e parashtruara nga ankuesi [REDACTED]
- II. ANULOHET masa disiplinore “Vërejtje me shkrim dhe mbishkrim në dosjen personale” e dates 10.07.2020 e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Mjekësisë Ligjore, ndaj ankuesit, si dhe çdo veprim tjetër i pasuar lidhur me masë disiplinore.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

[REDACTED], Ekspert Mjeko-Ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore pranë Ministrisë së Drejtësisë, me datë 09.10.2020 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2030/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore “Vërejtje me shkrim dhe mbishkrim në dosjen personale” të shqiptuar me datë 10.07.2020 nga Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Mjekësisë Ligjore.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.10.2020 ka proceduar në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën për përgjigje në ankesë. Me datë 28.10.2020, Ministria e Drejtësisë ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat përcjellëse të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike dhe vendosjes në mënyrë meritore ka administruar këto prova: Vërejtjen e datës 10.07.2020 të shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Mjekësisë Ligjore; Akt Emërim e datës 17.10.2017 për emërimin në pozite të ankuesit; Përshkrimin e detyrave të punës të ankuesit; Vendimin nr.16/2020 të datës 04.03.2020 për emërimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Institutit të Mjekësisë Ligjore; dhe E-mailin e datës 07.07.2020 ta Naim Ukës, drejtuar zv.Ministrit të Ministrisë së Drejtësisë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe analizimit të provave të parashtruar nga palët, konstaton se ankesa e ankuesit është e bazuar, **sepse:**

Kolegji për shqyrtim e ankesave, bazuar në Akt Emërimin e datës 17.10.2017, ka konstatuar së ankuesi mbanë pozitën e punës "Ekspert Mjeko-Ligjor" në Institutin e Mjekësisë Ligjore pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, me Vendimin Nr.16/2020 të datës 04.03.2020, ka formuar Grupin Punues për hartimin e Projekt Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Institutit të Mjekësisë Ligjore. Pas miratimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, me datë 07.07.2020, anëtari i grupit punues Naim Uka, në emër të anëtarëve tjerë të grupit punues (Dr. ██████████, Dr.Musa Gashi, Dr.Driton Haliti, dhe Dr.Nardi Sherxhiu), duke mos mbajtur në njoftim (cc) Drejtorin e Përgjithshëm të Institutit të Mjekësisë Ligjore, përmes e-mailit zyrtar i është drejtuar zv.Ministrit të Ministrisë së Drejtësisë, përmes të cilit ka reaguar lidhur me mos përfshirjen e propozimeve të tyre, përkatësisht ruajtjen e disa sektorëve të cilët i kanë konsideruar të rëndësishëm për Institutin e Mjekësisë Ligjore.

Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Mjekësisë Ligjore, pas informimit se Udhëheqësi i Divizionit për Identifikim, Koordinim dhe Përkrahjen, ka dërguar e-mail zyrtar në adresë të zv. Ministrit të Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën ka qenë i përfshirë edhe ankuesi, më datë 10.07.2020 ndaj ankuesit ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje me shkrim dhe mbishkrim në dosjen personale", për shkak të tejkalimit të hierarkisë, duke e konsideruar këtë veprim si shkelje të Kodit të Mirësjelljes.

Ankuesi, në ankesën e tij pretendon se masa disiplinore e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm, nuk është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar se masa disiplinore "Vërejtje me shkrim dhe mbishkrim në dosjen personale" ndaj ankuesit është shqiptuar përmes e-mailit zyrtar, dhe si e tillë nuk përmban këshillën ligjore me të cilën udhëzohet pala në ushtrimin e mjeteve juridike, kështu që Kolegji ka vlerësuar se ankesa e ankuesit e parashtruar me datë 09.10.2020 është ushtruar brenda afatit ligjore, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 127 paragrafi 3 ku

përcaktohet se: Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në Aktgjykimin Nr.ref.AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese, ka konstatuar së Ligji Nr.06/-L-114 për Zyrtares Publik, ka hyrë në fuqi me datë 09.07.2020, dhe i njëjti në kuadër të kapitullit IV, ka rregulluar në mënyrë të veçantë çështjen e disiplinës në Shërbimin Civil. Andaj, duke marr parasysh këtë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave vlerëson se Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Mjekësisë Ligjore gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit, duke u thirrur në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.

Bazuar në dispozitat e nenit 47 të Ligjit për Zyrtares Publik, masat disiplinore të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; largimi nga Shërbimi Civil. Andaj, meqenëse vërejtja hynë në kuadër të masave disiplinore e cila prodhon pasoja juridike për palën, Kolegji vlerëson se e njëjta duhet të shqiptohet përmes një akti administrativ, përmes të cilit konstatohet gjendja faktike, baza juridike, si dhe pala udhëzohet në ushtrimin e mjeteve juridike, konform dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtim e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës, me theks të veçantë e-mailin e datës 10.07.2020 përmes të cilës është shqiptuar masa disiplinore, ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Mjekësisë Ligjore, nuk ka bërë kualifikimin ligjor të shkeljes disiplinore, përkatësisht nuk ka specifikuar shkeljen disiplinore të kryer nga ankuesi, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 46 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtares Publik. Kolegji, po ashtu ka konstatuar se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, nuk janë marrë parasysh të gjitha elementet për vërtetimin e përgjegjësisë disiplinore të ankuesit ashtu siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtares Publik, përkatësisht nenin 45 ku përcaktohet se: *Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.* Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson së Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Mjekësisë Ligjore nuk ka arritur të argumentojë se veprimi i ankuesit bie ndesh me dispozitat e nenit 46, respektivisht nuk ka përshkruar dëmin i cili është shkaktuar nga veprimi i ankuesit, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 45 të Ligjit për Zyrtares Publik, kështu që Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamentin Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.Nr.295/2020

Ilire Mehmeti Shaqiri


Procesmbajtëse

Jeton KOÇA


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit 
- Sekretarit te Përgjithshëm të Ministrisë se Drejtësisë;
- Drejtorit të Përgjithshëm te Institutit te Mjekësisë Ligjore;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së